

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	04.03.2022	<p>Kërkesë për informacion, deleguar nga Ministria e Drejtësisë, ku kërkohej nga gazetar i MCN:</p> <p>Në Fletoren Zyrtare nr.30, viti 2022 është publikuar vendimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për çështjen “Laçi kundër Shqipërisë” që ka njohur si të drejta pretendimet e paditësit. Në parashtrimin e Gjykatës, ndër të tjera thuhet se: Më datë x, kërkuesi, i cili ishte i papunë dhe jetonte me një pension mujor prej x i kërkoi Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike (KSHNJ) një formular aplikimi për të kërkuar ndihmë juridike, në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së padisë, për shkak të varfërisë së tij. Kërkesa nuk mori përgjigje...</p>	09.03.2022	<p>U bë me dije si vijon:</p> <p>Ndihma juridike e garantuar nga shteti si mënyrë efçente dhe efektive është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi. Në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht se kjo e drejtë është sanksionuar që në tekstin origjinal të Kushtetuta në fuqi, në vitin 2008 u miratua për herë të parë një kuadër ligjor specifik që mundësonte ngritjen e një institucioni të posaçëm, përgjegjës për dhënien e ndihmës juridike falas, ligji nr.10039, datë 12.2008, "Për ndihmën juridike" Ligji nr.10039/2008 parashikonte kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti për personat pa mjete të mjaftueshme për të paguar shërbimin e dhënies së ndihmës juridike. Organi kompetent për dhënien e kësaj ndihme në bazë të kërkesës së subjektit përfitues ishte Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, organ kolegjal shtetëror i përbërë nga 5 anëtarë, me një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.</p> <p>Ndihma juridike klasifikohet në ndihmë juridike parësore dhe dytësore, ndërsa subjektet përfitues ishin personat në pamundësi financiare, të miturit dhe personat që përfitonin nga mbrojtja sociale. Ndihma juridike parësore dhe dytësore jepej nga personat që ushtronin profesionin e avokatit sipas një liste të përcaktuar nga KSHNJ, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisëku KSHNJ, në funksion të zbatimit të politikës shtetërore për ndihmën juridike merre vendime të</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>Efekti kumulativ i të metave në funksionimin e Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike dhe hezitimi i dukshëm i gjyqtarëve vendas për të përjashtuar personat me mjete të pamjaftueshme financiare nga taksa e akteve... Në këtë kuadër dhe në zbatim të ligjit kërkojmë të dimë dhe na vini në dispozicion:</p> <p>Praktikën e komunikimit të z. x me institucionin tuaj</p> <p>Arsyen e mospërgjigjes nga ana e institucionit tuaj sipas parashtrimit publik të Gjykatës</p> <p>Një koment mbi arsyetimin e gjykatës mbi “efektin kumulativ të të metave të funksionimit të “Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike”</p> <p>Sa kërkesa përpunon në vit institucioni juaj?</p>		<p>detyrueshme për zbatim nga avokatët, monitoronte cilësinë e shërbimit të dhënë, madje ishte edhe një ndër subjektet iniciues të procedimit disiplinor ligjit nr. 9109 datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Ofrimi ose jo i ndihmës juridike falas ishte në diskrecion të Kryetarit të KSHNJ dhe referuar nenit 15 të ligjit vendimi jepej duke patur parasysh: a) vlerën relative të ankesës apo pasurisë së përfshirë; b) bazueshmërinë në ligj të argumenteve ligjore dhe pretendimeve, të cilat paraqiten në emër të kërkuesit apo përfituesit; c) mundësinë e suksesit të ankesës apo të mbrojtjes; ç) kompleksitetin e çështjes; d) aftësinë e kërkuesit apo të përfituesit, që të vetëpërfaqësohet. Ndaj vendimit të kryetarit mund të bëhej ankim në KSHNJ brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij ndërsa kundër vendimit të refuzimit të dhënies së ndihmës juridike mund të bëhej ankim në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Por kishte kaluar gati një dekadë që nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe ashtu siç konstatohet nga progres raportet e shumta kombëtare dhe ndërkombëtare, sistemi i ndihmës juridike në Shqipëri mbetet mjaft larg standardeve ndërkombëtare dhe sidomos atyre Evropiane, drejt të cilave aspirojmë.</p> <p>Me iniciimin e Reformës në Drejtësi, një reformë e thellë që po prek në tërësi çdo element të sistemit aktual të drejtësisë, u iniciua edhe një reformim i thellë i sistemit të ndihmës juridike, duke ofruar një frymë të re, në sinkron me kërkesat dhe legjisllacionin e Bashkimit Evropian.</p> <p>Në vitin 2017, si pjesë e paketës ligjore e Reformës në Drejtësi, u miratua ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili e shfuqizoi ligjin e mëparshëm,</p>		
--	--	---	--	---	--	--

			<p>duke ofruar një qasje të re ndaj aksesit të grupeve vulnerabël. Ligji i ri përcjell një shtrirje më të plotë nga pikëpamja normative, duke e zgjeruar rrethin e subjekteve dhe objektit të ndihmës juridike falas, Me ligjin e ri, ndryshoi i gjithë sistemi i ndihmës juridike, mënyra e funksionimit dhe organizimit të këtij sistemi duke parashikuar tashmë në mënyrë të detajuar kategoritë të cilët do të jenë ofrues të këtij shërbimi. Krijohet për herë të parë një rrjetëzim institucionesh përgjegjëse dhe të angazhuara në ofrimin dhe garantimin e shërbimeve juridike me profesionalizëm dhe eficiencë. Miratimi i këtij ligji passolli hartimin e një pakete aketesh nënligjore të cilat synojnë rregullimin në mënyrë të detajuar të çdo procesi mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Standardizimi është një tjetër risi thelbësore që solli ky ligj për ndihmën juridike duke krijuar kështu një institucion të ri me procese të standardizuara në përputhje me të gjitha kriteret e kërkuara nga konventat dhe angazhimet mbikombëtare.</p> <p>Pavarësisht se ligji hyri në fuqi në vitin 2018, struktura e institucionit të ri, të dedikuar në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti (Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas) si dhe paketa e akteve nënligjore nuk ishte miratuar ende. Në të gjitha raportet kombëtare dhe ndërkombëtare evidentohet vonesa në ngritjen e skemës së ndihmës juridike si një pjesë e hallkës së reformës në drejtësi e cila filloi që në vitin 2016, me qëllimin kryesor rritjen e aksesit të qytetarëve në drejtësi.</p> <p>Struktura e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas u miratua me Urdhër nr. 59 dt. 25.03.2019, të Kryeministrit. Ishte Korriku i vitit 2020, muaji në të cilin struktura e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas filloi të funksionojë me kapacitete të plota, pasi nuk kishte të emëruar titullar institucioni. Me gjithë sfidat e një viti pandemik,</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>një nga objektivat kryesorë të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për vitin 2020, ishte ngritja e një sistemi funksional të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.</p> <p>Me hyrjen në fuqi të 111/ 2017, tashmë ofrohen 3 (tre) forma shërbimi të ndihmës juridike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Ndihma Juridike Parësore; 2.Ndihma Juridike Dytësore; 3.Përfashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, si edhe përjashtimi nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor që përballohet me fondet e DNJF. <p>•Ndihma juridike parësore, konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Informacion në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; -Këshillim ligjor; -Këshillim mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; -Ndihmë në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; -Përfaqësim përpara organeve administrative; -Dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore. <p>Referuar nenit 13 të ligjit Ndihma juridike parësore jepet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) punonjësit me trajnim të posaçëm; b) organizatat jofitimprurëse të autorizuara; c) klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë. 	
--	--	--	---	--

				<p>Përgjatë vitit 2018, këta ofrues nuk kanë qenë funksionalë, në kushtet kur Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nuk kishte ende një strukturë të miratuar dhe të rekrutuar (periudhë tranzitore). Në vitin 2019-2020, ishte funksionale vetëm një zyrë ligjore falas pranë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan financuar nga OSFA (mbyllur për shkak të mos vijmësisë së projektit). Tashmë për vitin 2022, është bërë e mundur ngritja e një sistemi të konsoliduar me 34 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore me parimin (1 ofrues për çdo qark) si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> 10 Qendra të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (Tiranë, Durrës, Fier, Lushnje, Vlorë, Gjirokastër, Pogradec, Shkodër, Lezhë, Dibër); 8 Qendra me financim nga UNDP dhe 2 qendra me financim nga buxheti i shtetit; <input type="checkbox"/> 12 organizata jofitimprurëse të autorizuara për herë të parë për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga Ministri i Drejtësisë; <input type="checkbox"/> 12 Marrëveshje Bashkëpunimi me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë. <p>Të planifikuara për t'u hapur përgjatë vitit 2022, edhe 4 (katër) Qendra të tjera të shërbimit të ndihmës juridike parësore me qëllim mbulimin me ofrues shërbimi në të gjithë territorin e RSH sipas qarqeve</p> <p>Konsolidimi i sistemit të ndihmës juridike parësore por edhe puna intensive e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në promovimin e sistemit (125 aktivitete ndërgjegjësuese; 5 intervista televizive të realizuara vetëm për vitin 2021) ka passjellë një rritje progresive të numrit të qytetarëve përfitues nga shërbimet e të ndihmës juridike parësore nga 23 raste për vitin 2019, në 4191 raste për vitin 2020, dhe në 8153 raste për vitin 2021.</p> <p>Gjithashtu, për herë të parë në rajon u mundësua një platformë online e dedikuar shërbimeve</p>	
--	--	--	--	---	--

			<p>ligjore falas (juristionline.al) si dhe vendosja në dispozicion i numrit të gjelbër 08001010.</p> <p>Nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas edhe në kushtet e pandemisë. Gjithashtu, në Janar të vitit 2021, funksionoi E-albania për ndihmën juridike. Tashmë qytetarët mund të sharkojnë në E-albania në kohë reale, formularët e kërkesës për ndihmë juridike si dhe të njihen me adresat dhe kontaktet e të gjithë ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike.</p> <p>•Ndihma juridike dytësore, konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; -Ofrimin e këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. <p>Për të përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike dytësore qytetarët mund të drejtohen pranë Gjykatave të Rrethit Gjyqësor përmes depozitimit të formularit tip të kërkesës për ndihmë juridike dytësore. Ndihma Juridike Dytësore ofrohet nga avokatë, ofrues të ndihmës juridike dytësore në 100% të territorit të RSh sipas qarqeve.</p> <p>Theksojmë se ndryshe nga sistemi i vjetër, tashmë me sistemin e ri të ndihmës juridike, organi kompetent për pranimin ose jo të kërkesës për avokat falas apo përjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore është ekskluzivisht gjykata (ndryshe nga sistemi i vjetër i cili e pranonte këtë kërkesë nëpërmjet një akti administrativ të Komisionit). Me pranimin e kërkesës nga gjykata sipas</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>procedurave të përcaktuara në kreun V të ligjit, vendimi i gjykatës i komunikohet Dhomës Vendore të Avokatisë e cila cakton një avokat nga lista e avokatëve ofrues të ndihmës juridike sipas parimit të rotacionit.</p> <p>Roli i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në skemën e ndihmës juridike dytësore është monitorimi i cilësisë së shërbimit të avokatëve si dhe kryerja e pagesës për avokatët dhe ekspertët ligjor në fund të procesit.</p> <p>Sa më sipër, përfshirja e një sërë institucionesh përgjegjëse për ndihmën juridike përfshirë këtu dhe institucionet e pavarura si gjykatat, përbën një garanci shtesë në kuadër të mbrojtjes së të drejtës së qytetarëve.</p> <p>Sa i përket ndihmës juridike dytësore, nëse në vitin 2019, kanë rezultuar 60 avokatë në listën e avokatëve ofrues të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, në vitin 2020 ky numër pëson një rritje prej 70 avokatësh. Ishte viti 2021 ai i cili sollti një 2 (dy) fishim të numrit të avokatëve në 124 avokatë ndërsa në vitin 2022, janë kontraktuar 202 avokatë.</p> <p>Rritja progresive e interesit të avokatëve për t'u bërë pjesë e ndihmës juridike dytësore është një tregues i qartë që sistemi i ndihmës juridike dytësore është funksional dhe i gatshëm për qytetarët në nevojë.</p> <p>Ky fakt rezulton dhe nga numri i kërkesave për ndihmë juridike dytësore (përfaqësim me avokat të garantuar nga shteti në gjykatë). Vetëm përgjatë vitit 2021, kanë përfituar ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore 671 persona (nga 849 vendime gjyqësore në total), një 7-fishim i rasteve të trajtuara krahasimisht me vitin 2020 (181 raste në total).</p> <p>Numri i vendimeve gjyqësore të administruara për ndihmë juridike dytësore, përkthehet drejtëpërdrejtë në kosto për buxhetin e shtetit si</p>	
--	--	--	---	--

				<p>dhe në rritjen e numrit të përfaqësimeve gjyqësore të cilat duhet të mbikëqyren për nga cilësia e shërbimit, nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, pjesë e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.</p> <p>Gjithashtu, në mënyrë të përmbledhur gjeni dhe disa nga proceset kryesore të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të konsolidimit të sistemit të ri të ndihmës juridike (përgjatë periudhës Korrik 2020-Shkurt 2022):</p> <ul style="list-style-type: none"> -U mundësua që Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të ketë një Strategji të saj 5 (pesë) vjeçare, në bashkëpunim me organizatën mbështetëse EURALIUS V; -U mundësua hartimi, miratimi dhe hyrja në fuqi i të gjithë paketës së akteve nënligjore që rregullonin organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas; -Bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare u hartua me mbështetjen e Euralius V, Manuali i ligjit për ndihmën juridike i cili shërbeu si një material orientues dhe udhëzues për të gjithë institucionet e përfshira në skemën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti; -U konsolidua marrëdhënia me donatorët UNDP dhe OSFA; -Në saj të bashkëpunimit dhe mbështetjes së Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) tashmë Drejtoria krahas 2 (dy) Qendrave me buxhet shteti administron 8 (tetë) Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore; -U mundësua rekrutimi i 18 (tetëmbëdhjetë) punonjësve pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore si dhe lidhja e 9 (nëntë) marrëveshjeve të bashkëpunimit “Për ofrimin e ambienteve pa kundërshtim për tu përdorur si Qendra të Shërbimit të Ndihmës 	
--	--	--	--	--	--

			<p>Juridike Parësore” me Bashkinë Vlorë; Lushnje; Lezhë dhe Pogradec; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër; Dibër dhe Durrës; ADISA Fier dhe Gjirokastrë;</p> <p>-Në saj të bashkëpunimit me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, është duke i dhënë fokus edukimit ligjor të publikut përmes 2 (dy) paraligjorëve të cilët shërbejnë si një urë lidhëse kontakti midis ofruesve të shërbimit dhe qytetarëve në zonat më të thella të Tiranës;</p> <p>-U krijuan urat e bashkëpunimit me të gjithë Gjykatat e Republikës së Shqipërisë përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit. Objekti i këtyre marrëveshje konsiston në bashkëpunimin e institucioneve sa i përket shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim ndërmarrjen e masave për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe në veçanti të grupeve vulnerabël në kushtet kur referuar ndryshimeve ligjore, Gjykatat në Republikën e Shqipërisë ndodhen në cilësisë e institucioneve, drejtëpërdrejtë përgjegjëse për pranimin ose jo të kërkesës për ofrimin e ndihmës juridike dytësore, të garantuar nga shteti;</p> <p>-Sa i përket forcimit të kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, vetëm për vitin 2021: 17 punonjës në 10 qendra i janë nënshtruar trajnimit të detyrueshëm mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti në bashkëpunim me ASPA dhe UNDP; 32 studentë të angazhuar pranë 10 Klinikave të Ligjit i janë nënshtruar trajnimit me temë “Aksesi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, organizuar nga DNJF;120 avokatë, ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore i janë nënshtruar trajnimit të detyrueshëm në bashkëpunim me UNDP dhe DhASh;</p>	
--	--	--	---	--

			<p>-Është bërë i mundur monitorimi i cilësisë së shërbimit të 10 (dhjetë) Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore dhe avokatëve ofrues të ndihmës juridike dytësore;</p> <p>-Është dhënë kontributi në kuadër të Strategjive dhe Raportimeve Ndërkombëtare në kushtet kur Aksesi në Drejtësi është një komponent shumë i rëndësishëm i sanksionuar nga shumë akte ndërkombëtare. Përmendim këtu angazhimin në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP); Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND); Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK); Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM); Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP); Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 etj;</p> <p>-Janë zhvilluar mbi 185 aktivitete ndërgjegjësuese/edukimit ligjor të publikut në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Rezultatet e sipërcituara tregojnë qartazi se pavarësisht faktit se Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është institucion i krijuar rishtazi, efektiviteti dhe produktiviteti i skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti ka patur një impakt mëse pozitiv në kuadër të përmushjes së misionit madhor “Garantimit të aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët si një e drejtë themelore me karakter kushtetues”.</p> <p>Nga ana tjetër, nuk mund të mohohet fakti që ende nevojitet një punë shumë e madhe në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve që tashmë ekziston një sistem funksional i ndihmës juridike falas ku ata mund të drejtohen.</p> <p>Ky fakt përforcohet edhe më anë të kësaj kërkesë për informacion ku vihet re që edhe nga</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>mediat ka një mungesë informacionit mbi sistemin e ri të ndihmës juridike.</p> <p>Në këtë kuadër, duke qenë mëse të vetëdijshëm për rolin thelbësor të medias në informimin e qytetarëve, do të kërkonim mbështetjen tuaj në drejtim të informimit të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti nëpërmjet zhvillimit të një interviste apo spoti televiziv.</p> <p>Qëllimi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që nga momenti i funksionimit ka qenë që të jetë sa më transparente dhe sa më afër qytetarëve. Ndaj ju ftojme që të na ndiqni në faqen tonë zyrtare, rrjetet sociale facebook dhe Instagram si dhe në platformën juristionline.al për tu përditësuar mbi çdo ecuri, në linqet si vijon: Faqja zyrtare: https://ndihmajuridike.gov.al/ Instagram: https://ëëë.instagram.com/drejtoriandihmesjuridikefalas/?hl=en Facebook: https://ëëë.facebook.com/ndihmejuridikefalas Platforma juristionline: https://juristionline.al/questions_of_civil/</p> <p>Sa i përket praktikës së komunikimit me z. Mustafa Laçi, në kushtet kur kjo praktikë është përcjellë përpara krijimit të institucionit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kjo e fundit nuk administrohet nga ana jonë.</p> <p>Theksojmë se referuar nenit 36 të ligjit nr. 111/2017, “Të gjitha të drejtat, detyrimet, qendrat ekzistuese të shërbimit të ndihmës juridike, buxheti, si dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i kalojnë dhe administrohen nga aparati i Ministrisë së Drejtësisë”</p>	
--	--	--	--	--	--

				Si rrjedhojë, praktika e komunikimit të M.L, mund të gjendet e administruar pranë Sektorit të Arkiv Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë ku ka operuar edhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike.		